



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR
NË PROFILIN MËSIMOR “AGROBIZNES”, NIVELI III

(Drejtimi mësimor “Ekonomi bujqësore”)

TIRANË, 2015

Programi orientues për provimin përfundimtar të praktikës së integruar të profilit mësimor **”Agrobiznes”**, **Niveli III** përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më

përfaqësuese për këtë profil mësimor, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për prindërit, ky program jep informacionin për vëllimin e punës që kërkohet të bëjnë fëmijët e tyre dhe ndihmon në caktimin e një regjimi të përshtatshëm ditor për ta.

Për drejtuesit e arsimit profesional të të gjitha niveleve, ky program krijon mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar teste përmblendhëse.

Gjatë punës me këtë program kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimin përfundimtar, është e rëndësishme që herë pas here instruktorët të zhvillojnë teste të nxënësve me teste praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në profilin mësimor "**Agrobiznes**", **Niveli III** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë, mbrojtjes së mjedisit, si dhe rregullat teknike të profesionit.	Gjatë të gjitha detyrave	5
2	Bashkëbisedim profesional.	Gjatë të gjitha detyrave	10
3	Të aplikojë për kalimin e fermës nga sistemi i prodhimit të zakonshëm në atë organik.	Detyra 1: Konceptimi i një projekti për ngritjen e një fermë organike.	20

4	Të llogarisë mundësinë dhe nevojat e financimit në ekonominë bujqësore.	Detyra 2: Llogaritja e nevojës për financim në krijimin e një biznesi (fermë bujqësore, blegtorale, mikse), në ekonominë bujqësore.	20
5	Të bëjë regjistrimin kontabël të veprimeve të ndryshme ekonomike në ekonominë bujqësore.	Detyra 3: Kryerja e regjistrimeve kontabël e veprimeve që lidhen me aktivet afatgjata, veprimet jashtë administrimit, veprimet e arkës, me shpenzimet e punës, TVSH-në dhe llogaritjen e rezultatit përfundimtar të ekonomisë bujqësore.	20
6	Të hartojë dhe zbatojë planin e prodhimit në ekonominë bujqësore.	Detyra 4: Hartimi dhe zbërthimi i një plani të thjeshtë prodhimi dhe përcaktimi i përgjegjësive.	25
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “**detyra pune**”, në mjedise të simuluar në zyrën e firmës ushtrimore.
- Nxënësit do të vlerësohen për 6 kompetenca bazë, ku 2 kompetencat e para janë kros-profesionale dhe verifikohen gjatë kryerjes së proceseve në 4 detyrat e përcaktuara.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësim edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.